



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:101321
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05427340

AA.nr.738/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.K Komuna e Prishtinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate Lendita Keqekolla Gashi nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1392/2020 të datës 07.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1392/2020 i datës 07.09.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1392/2020 të datës 07.09.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tersi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.K Komuna e Prishtinës. Në pikën II të dispozitivit e ka anuluar vendimin me nr.8577 të datës 01.06.2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve. Në pikën III të dispozitivit e ka obliguar të paditurën Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, që paditësit B.K Komuna e Prishtinës, t’ia paguaj kompensimin për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë, nga data 23.12.2019 e deri me datë 23.12.2022, apo gjithsej 36 muaj duke e llogaritur për muaj diferencën prej 225€, në mes të dy grupeve Paraplegjik dhe Tetraplegjik apo gjithsej shumën prej 8,100.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën IV të dispozitivit ka vendosur që

ky aktgjykim e zëvendëson vendimin me nr.8577 të datës 01.06.2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve. Në pikën V të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës jokontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar të anulohet ashtu çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin me nr. 8577 e dt. 01.06.2020 e ka refuzuar si të bazuar ankesën e z/znj. B.K, me numër të ID-së... për njohjen e të drejtës në kompensim për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Grupit të parë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 24.08.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës vlerëson se gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar. Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë konflikt administrativ, përkatësisht se cilit grup të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik i takon paditësi, gjykata e shkallës së parë në seancën gjyqësore të datës 11.05.2022, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore të cilën ekspertizë e ka obliguar që ta kryej Shërbimi Spital dhe Klinikë Universitar i Kosovës-Qendra Klinike Universitare e Kosovës, përmes një komisioni mjekësor prej tre mjekeve specialist në përbërje prej një mjek neurolog, një mjek fiziatër, dhe një mjek kirurg. Drejtori i Përgjithshëm i SHKUK-së me vendimin me nr.protokolli 6065/2 të datës 08.09.2022, ka caktuar ekspertët mjekësore në përbërje prej Dr.D.B-neurolog-kryetar, Dr.S.G-fiziatër-anëtar dhe Dr.S.Z-kirurg-anëtar, për ta kryer ekspertizën mjekësore sipas detyrave të caktuara nga gjykata. Komisioni mjekësore në

përbërje prej mjekësve specialist pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit me datë 17.01.2023 dhe analizimit të dokumentacionit mjekësor në shkresat e lëndës kanë përpiluar raportin e ekspertizës mjekësore ku kanë dhënë konstatimet se pacienti hynë tek personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik ka humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të poshtme-paraplegia sipas Ligjit nr.05/L-067 për Njohjen e Statusit dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.09.2023 ekspertja mjekësore e pranishme në seancë Dr.S.G-fiziatre ka deklaruar se mbetem në tersi pran raportit mjekësor i cili i është dorëzuar gjykatës. Ka theksuar se raporti mjekësor është përpiluar bazuar në ekzaminimin fizik të paditësit dhe shqyrtimin e dokumentacionit mjekësor i cili ka qenë në shkresat e lëndës. Bazuar në këtë në kemi ardhur deri te mendimi i paraqitur në ekspertizë, sipas të cilës paditësi në këtë rast bënë pjesë tek personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në mënyrë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve dhe se përveç dëmtimeve të ekstremiteteve paditësi ka inkontinence të urinës (Alviet urina). Tutje ekspertja mjekësore në pyetjen e të autorizuarës së paditësit se bazuar në ekzaminimin e paditësit dhe në dokumentacionit mjekësor, por edhe deklarimit që e bëtë në këtë seance, a mund të arrihet në konstatimin se paditësi bënë pjesë tek personat me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinence, humbje të plote dhe të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubitueseve, Ajo gjithashtu theksoj se gjykatën e shkallës së parë e njoftoj që në raport në faqen e parë të tij gabimisht është shënuar emri i pacientit P.E e që në këtë rast është dashur të jetë paditësi B.K. Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë cekur më lartë, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në ligj dhe fakte. Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e datës 17.01.2023 e mjekësve specialist Dr.D.B-neurolog, Dr.S.G-fiziatër-anëtar dhe Dr.S.Z-kirurg-anëtar, të cilës gjykata ja fali besimin në tërësi, sepse e njëjta ishte profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ, si dhe bazuar në vendimin e të paditurës të datës 17.01.2023, nga ku vërtetohet se vet e paditura në procedurë të rivlerësimit i ka njohur/vazhduar të drejtën paditësit për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Grupit të parë prej datë 23.12.2022 në shumë mujore prej 375€, gjykata erdh në përfundim se në rastin konkret paditësi i plotëson kushtet ligjore nga neni 1 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, dhe neni 7 dhe 8 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, si dhe neni 5 par. 1 pika 1.3 dhe 1.4 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, për të qenë përfitues i kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë nga data 23.12.2019 e deri me datë 23.12.2022, për gjykata vendosi ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurën në dispozitivin e III të aktgjykimit që paditësit, t'ia paguaj kompensimin për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë, nga data 23.12.2019 e deri me datë 23.12.2022, apo gjithsej 36 muaj duke e llogaritur për muaj diferencën prej 225€, në mes të dy grupeve Paraplegjik dhe Tetraplegjik apo gjithsej shumë prej 8,100.00€. Në vlerësimin e tërësishëm të çështjes, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditësi i plotëson kushtet ligjore për të qenë përfitues i kompensimit nga grupi i parë i

personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, për arsye se, i njëjti siç kanë konstatuar mjekët specialist të cilët e kanë kryer ekspertizën mjekësore për paditësin, paditësi në këtë rast bënë pjesë tek personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik ka humbur në mënyrë të përhershme mundësin e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve dhe se përveç dëmtimeve të ekstremiteteve paditësi ka inkontinence të urinës (Alviet urina), prandaj e paditura duhet t'ia paguaj kompensimit paditësit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë, nga data 23.12.2019 kur paditësi ka parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës për kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik tek e paditura, e të cilën të drejtë e paditura ja kishte njohur me vendimin e datës 17.01.2020, nga data 23.12.2019, por në grupin e dytë në vlerë të kompensimit prej 150€ në muaj e deri me datë 23.12.2022, kur e paditura paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik, tani nga grupi i parë në shumë mujore prej 375€.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur kërkesëpadinë e paditësit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe atë se Gjykata Themelore në Prishtinë nuk u bazua në faktet e dhëna nga e paditura. Kështu që gjendjen faktike e nxori komplet nga provat e paditësit që ishte jo e plotë dhe e gabuar. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, meqë nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ është vërtetuar se paditësi i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e datës 11.05.2022 e mjekëve specialist të cilës gjykata e shkallës së parë me të drejtë ja fali besimin në tërësi, e cila është profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ. Pra gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate po ashtu nuk i aprovoi, për faktin se ekspertiza mjekësore është e qartë dhe nuk ka kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re. Andaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.738/2023, me datë 06.03.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi